


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr.AKK-03-4269/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Ilir Abdullahu, Drejtor Teknik ne KUR-Prishtina për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-4269/14, qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Ilir Abdullahu, Drejtor Teknik ne KUR-Prishtina.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Ilir Abudullahu, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, Drejtor Teknik ne KUR-Prishtina, është i angazhuar ne veprimtari private si pronar dhe person i autorizuar, ne një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.11.2014, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Ilir Abdullahu, ka ardhur ne takim ku është takuar me zyrtarët e AKK-së, dhe i janë prezantuar faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin për konflikt te mundshëm te interesit.

z. Abdullahu, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por na ka njoftuar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe ka mbetur vetëm si biznes i regjistruar në ARBK dhe është zotuar se brenda afatit ligjorë do ta bëjë ndryshimin e kërkuar nga AKK.

Me datën 23.12.2014, kemi marrë njoftimin zyrtar nga ARBK, ku dëshmohet se janë bërë ndryshimet e kërkuar dhe dëshmohet se z. Ilir Abdullahu, nuk figuron si person i autorizuar në biznesin N.T.SH "Ing Corp" me nr 70310552.

Vlerësojmë se pas ndryshimeve të bëra në biznes, dhe pas rrethanave të krijuara është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin z. Ilir Abdullahu, Drejtor Teknik në KUR-Prishtinë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

